



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

### KRITERET DHE DOKUMENTAT PËR HARTUES/KORRIGJUES

Kandidatët e interesuar për të marrë pjesë si hartues/korrigjues në provimet e sezonit 2018 dhe që plotësojnë kriterët e rregullorës “Për funksionimin e Komisionit të Provimeve të Aftësisë Profesionale dhe mbikëqyrjes së procesit të testimit të kandidatëve për Auditues Ligjorë dhe Kontabilist të Miratuar”, duhet të paraqesin pranë sekretarisë teknike në organizatën profesionale (IEKA) dokumentat si më poshtë.

*Bazuar në nenin 5 të rregullores pika 4;*

Çdo kandidat që aplikon për hartues dhe korrigjues duhet të paraqesë zyrtarisht dokumentacionin e mëposhtëm pranë sekretarisë teknike të KPAP-së:

- a) Kërkesë me shkrim;
- b) Curriculum Vitae;
- c) Referencë ose dokument zyrtar për të vërtetuar përvojën në fushën përkatëse për të
- d) cilën po aplikon;
- e) Fotokopje të diplomave;
- f) Rekomandime nga punëdhënësit ose pedagogë të fushave përkatëse ose certifikata që
- g) vërtetojnë eksperiencën profesionale, aftësitë pedagogjike, si dhe integritet moral dhe reputacion të mirë;
- h) Çertifikatën e gjendjes gjyqësore (informacion për rekord penal) ose formular i vetëdeklarimit për gjendjes gjyqësore.

Provimet e sezonit 2018:

1. Zbatimi në praktikë i kërkesave të etikës profesionale dhe procedurat e punës për auditimin e pasqyrave financiare, sipas kërkesave të standardeve ndërkombëtare të auditimit;
2. Zbatimi i modeleve të duhura të organizimit, drejtimit, qeverisjes dhe kontrollit të brendshëm të njësive ekonomike të biznesit (personave juridikë); Përdorimi i sistemeve të informacionit dhe të informatikës.

*Bazuar në nenin 5 të rregullores pika 2;*

Kriteret që duhet të plotësojnë hartuesit dhe korrigjuesit janë si më poshtë:

- a) Hartuesit duhet të plotësojnë një nga kërkesat e mëposhtme:
  - i. Diplomë “Master i Shkencave” ose “Master i Arteve” apo të barazvlefshme me to si dhe titullin, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, dhe 6-10 vite përvojë pune në fushën përkatëse;
  - ii. Gradë apo titull shkencor apo të barazvlefshme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë dhe minimalisht 5 vite përvojë pune në fushën përkatëse;
  - iii. Aftësi për të hartuar teste dhe aftësi për të hartuar dhe zgjidhur në mënyrë pragmatike rastet studimore.

- b) Korrigjuesit, duhet të plotësojnë të paktën kërkesat e mëposhtme:
- i. Diplomë “Master i Shkencave” ose “Master i Arteve” apo të barazvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;
  - ii. dhe mbi 3 vite përvojë pune në fushën përkatëse.
- c) Njohuri të mira të standardeve profesionale dhe/ose kuadrit rregullaor të lidhur me fushën në të cilën do angazhohen si hartues dhe korrigjues dhe të kenë përvojë praktike lidhur me fushën përkatëse;

Kërkesa drejtuar Komisionit të Provimeve të Aftësisë Profesionale sëbashku me dokumentacionin shoqërues do të dorëzohet pranë sekretarisë teknike në organizatën profesionale, IEKA.

**Periudha e pranimit të dokumentave do të jetë si më poshtë:**

1. Hartues/korrigjues provimi në disiplinën “Zbatimi në praktikë i kërkesave të etikës profesionale dhe procedurat e punës për auditimin e pasqyrave financiare, sipas kërkesave të standardeve ndërkombëtare të auditimit”.

***Periudha 6 – 13 nëntor 2018***

2. Hartues/korrigjues provimi në disiplinën “Zbatimi i modeleve të duhura të organizimit, drejtimit, qeverisjes dhe kontrollit të brendshëm të njësive ekonomike të biznesit (personave juridikë); Përdorimi i sistemeve të informacionit dhe të informatikës”.

***Periudha 23 – 27 nëntor 2018***